



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më 27.01.2021 me fillim në ora 15.30. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari-** Më lejoni t'i përvendes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSBB, Nënkyetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtoret e Drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përparrë e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2021 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Ky është takimi i parë për vitin 2021 i KKSBB-së. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

### Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rrëth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
  - Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak;
  - Siguria ne Trafik;
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për Sigurinë në shkolla;
  - Rrëth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit;
4. Të ndryshme.

**Kryetari** - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të dites, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar rendi i dites. Kalojmë në pikën e radhës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Nvsret Abazibra** – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket procesverbalit besoj se është bërë një gabim teknik, por ceket se në komunën tonë ka pasur 445 vdekje, kurse në realitet kanë qenë 45, kjo vetëm le të përmirësohet se është gabim teknik.

Kryetari – Faleminderit i nderuar hoxhë, këtë gabim teknik do ta përmirësojë sekretaria e kuvendit, nëse nuk ka askush tjetër të shtojë diçka sa i përket procesverbalit e qesë në votim: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar procesverbalii nga mbledhja e kaluar.

**2. Informatë rrëth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit.**

**Kryetari** – Përvendetje për të gjithë të pranishmit në sallë, të nderuar sa i përket menaxhimit të situatës me Covid – 19, aktualisht i kemi 98 raste aktive, 60 raste i kemi me fatalitet, kurse 445 të rasteve janë të shëruar. Sa i përket masave që janë në fuqi si duket nga kjo fryma parazgjedhore

nuk mundem tē ju sigurojē se janē duke u respektuar nē masēn e duhur, por kērkesa jonē ūshtē qē tē respektohen kēto masa aq sa munden. Edhe pse ūshtē duke u pērfolur se kēto dy muajt e fundit jemi duke shkuar ka fundi i pandemisë, mirē ūshtē qē tē **kujdesemi** deri sa tē pērfundon e gjitha, ata tē cilēt kanē humbur familjarë nga pasoja e Covid – ju shpreh ngushëllime, kurse ata qē janē ende me covid – 19 urojmë qē ta pērballojmë sa mē lehtë kētë viruse. Ekipet tona shëndetësore janē aktive dhe tē gatshme, pra janē funksionale dhe janē duke u pērpjekur ta kryejnē punën e tyre sipas mundësive qē i kanë. Ne si institucion kemi informacione me baza ditore nga IKSHP-ja. Poashtu edhe furnizimi me medikamente dhe me pajisje mbrojtëse ndaj covid – 19 ūshtē i mirē, nuk qēndrojmë keq sa i pērket furnizimeve. Pēr mē shumë e hapi debatit nēse ka dikush tē shtoj diçka ose tē pyes fjala ūshtē e juaja.

**Ramë Berisha** – Pērhëndetje pēr tē gjithë tē pranishmit, ky viruse ūshtē i pērhapur qē nga marsi i viti tē kaluar nē gjithë botën, ka pasur pasojë si nē njerëz ashtu edhe nē ekonomi. Por ajo qē ūshtē emirë se si ministria ashtu edhe komuna na ka dalë nē ndihmë pēr tejkalim tē kētij virusi, poashtu edhe kryetari i komunës sē bashku me komandantin e policisë nē çdo mbledhje na kanë informuar rreth covid-19, prandaj edhe unë i bëjë thirrje qē ti pērmbahemi ende rekomandimeve sepse nēse jo do tē kemi edhe mē shumë pasoja sepse virusi ende nuk ka kaluar.

**Krvetari** – Ne jemi duke planifikuar qē nē një tē ardhme tē shpejtë tē i mbështesim disa biznese tē cilat kanē pasur humbje si pasojë e covid -19, poashtu edhe nga punimet e kanalit tē ujërave nē rrugën kryesore nē qytet.

**Konkluzion** – Duhet tē pērpiqemi tē gjithë tē i respekojmë masat edhe pse tanë nē kētë kohë ūshtë pak problem, lutemi qē tē zbutet efekti i virusit dhe tē mos kemi asnjë rastë me fatalitet. Kalojmë nē pikën e radhës:

**3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes sē sigurisë nē territorin e Komunës sē Rahovecit.**  
 Gjendja e sigurisë nē komunën e Rahovecit pēr bindjen tonë ūshtë stabile dhe e qetë, kemi pasur një pērballim tē vështirë me situatën e vërvimeve dhe pērmbytjeve nē disa fshatra tē komunës sē Rahovecit dhe nē qytet. Kemi pasur ngritje tē nivelit tē ujtit nē Drinit e Bardhë ku i ka kërcënuar fshatrat qē janë afër, por ashtu vazhdon ende tē jetë rrezik pēr ato fshatra. Ne si komunë kemi marrë veprime tē shumta emergjente, përmes kompanive dhe ekipave vullnetare, ku jemi munduar qē ta pērballojmë sa mē mirë dhe sa mē lehtë gjendjen e rënduar me rastin e vërvimeve dhe pērmbytjeve tē fundit. Kemi formuar komisione sa i pērket regjistrimit tē dëmeve si nē amvisëri, ekonomi familjare dhe biznese, dëmeve nē infrastrukturë publike dhe nē bujqësi. Vlera e dëmeve nē amvisëri ūshtë mbi 600,000.00 €, këtë raporte e kemi dërguar nē komisionin pēr kompensimin e dëmeve nē kuadër tē qeverisë qendrore, ne jemi nē pērfundim tē përgatitjes edhe tē raporteve tjera sa i pērket dëmeve tē shkaktuara nga reshjet e fundit. Ne kemi shpresë qē do tē kemi një dëmshpérblim nga ana e qeverisë qendrore, ekziston një fond emergjent qē ūshtë krijuar posaçërisht pēr ti mbuluar dëmet nē amvisëri, ne si komunë e kemi bërë presionin nē adresë tē institucioneve qendrore. Poashtu ekziston edhe një fond emergjent edhe nē Ministrin e Bujqësisë, shpresojmë se edhe nga ky fond do tē kompensohem i pēr dëmet nē bujqësi qē i ka pasur komuna jonë. Sa i pērket problemeve ndëretnike nuk kemi pasur gjithçka ūshtë nē rregull, nē natën e vitit tē ri nuk kemi pasur ndonjë problem, ka pasur gjuajtje tē fishekzjarrëve edhe pse ne kemi marrë një vendim qē tē kufizohet përdorimi i tyre, por qē tē ndodhë kjo duhet tē ndërpritet importi i tyre nē burim e jo nga ne. Pēr mē shumë sa i pērket kësaj pike besoj se do na jep mē shumë informata komandanti i stacionit policor z. Fazli Morina.

**Fazli Morina, komandanti i stacionit policor** – Pērhëndetje pēr tē gjithë tē pranishmit, do mundohem nē pika tē shkurta tē ju raportoj edhe pse ka mjaftë pēr tē thënë. Nēse i referohemi raportimit nga takimi i fundit e deri me 25 janar tē kētij viti, do ju japë edhe disa informata shtesë rreth vitit 2020, pasi jemi nē mbledhjen e parë tē vitit 2021. Pasi qē nē takimet e kaluara kemi rapportuar nē mënyrë kronologjike duke i përfshirë datat nga mbajtja e takimit paraprak tē KKSB-së e deri nē takimin e radhës. Informatat rreth menaxhimit tē pandemisë covid – 19, nē zonën tonë tē përgjegjësisë, gjate periudhës reportuese, tē gjitha njësitë e policisë nē Rahovec tē

asistuara edhe nga patrullat e tjera kohë pas kohe, kanë qenë të angazhuara në implementimin e planit operativ të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë për gatishmëri dhe reagim për Corona Virus Covid – 19, duke vepruar në përputhje me zhvillimet aktuale dhe vendimet tjera, për menaxhimin e situatës së pandemisë, në tërë territorin e komunës së Rahovecit. Gjatë periudhës mars – dhjetor 2020 në zonën tonë të përgjegjësisë janë shënuar rreth 1936 gjoba konform ligjit 07/L006, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid – 19. Nga këto gjoba 1911, janë për mos vendosje të maskës, 3 për mos mbajtje të distancës, 3 për mos respektim të orarit, 22 për tubime dhe aktivitete të ndaluara dhe 2 gjoba janë për mos respektim të masës për vet izolim.

Situata e sigurisë së përgjithshme gjatë viti 2020, në territorin e Komunës së Rahovecit, gjatë vitit 2020 ka qenë e qetë dhe stabile. Gjatë kësaj periudhe në stacionin tonë të policisë janë regjistruar 526 raste, nga to janë 493 vepra penale dhe 33 incidente të ndryshme jo të natyrës së veprës penale. 49 raste kanë qenë vjedhje, 66 vjedhje të rëndë, mbajtje të paautorizuar të armës 6 raste dhe dhuna në familje 47 raste. Dallimi në mes viti 2020 dhe viteve të tjera është shumë i vogël, pothuajse janë shifra të njëjtë sepse në vitin 2019 kemi pasur vetëm 2 raste më pak. Ajo që ja vlen të ceket poashtu është se gjatë kësaj periudhe janë bërë disa vjedhje të rënda, vjedhja në qendrën tregtare Viva Fresh Store në Rahovec, pastaj në Super Viva në Xërxe, pastaj vjedhja nga veturat të parkuara nëpër parkingjet e qendrave tregtare, vjedhjet e stolive nëpër shtëpi private etj. Për të gjitha këto raste janë marrë masa qoftë nga ne si stacion i Rahovecit, qoftë nga hetimet rajonale.

**Siguria në Komunikacionin Rrugorë**, është e njëjta pothuajse pa ndryshime, po ju ceki vetëm shifrat e gjobave mos të ju marrë kohë shumë, gjatë viti 2020 vetëm nga stacioni i Rahovecit janë shqiptuar 5086 tiketa.

**Siguria në Shkolla**, është pothuajse e njëjtë gjatë kësaj periudhe raportuese, situata ka qenë e qetë dhe stabile, në zonën tonë të përgjegjësisë janë raportuar 5 raste, një rast ka qenë në shkollën e mesme "Selajdin Mullabazi – Mici". Pastaj kemi pasur 1 rast të vjedhjes së gjérave ushqimore tek çerdha e fëmijëve Tulipanët, po ashtu edhe thyerja e xhamave në shkollën filllore "Hamëz Thaqi" në Xërxe. Një rast i cili ka ndodhur pardje është hedhja e një qytetari nga Ura e Fshejtë, tani për tanë rrëthanat janë të panjohura. Falë angazhimit të drejtorisë rajonale, nga stacioni ynë, pastaj nga komuna e Rahovecit si dhe nga FSK-ja, por për arsyet e motit të keq pasi ka pasur shumë vërvshime, njësitë e shpëtimit nuk kanë mundur të reagojnë, por tani janë duke vazhduar gjetjen e trupit të personit në fjalë. Nëse keni ndonjë pyetje këtu jemi për të ju përgjigjur.

**Kryetari** – Urojmë që të gjendet trupi i mësimdhënësit nga shkolla filllore në Sopniq, falënderoj FSK-në dhe të gjithë ata që kanë shprehur gatishmërinë për të kërkuar trupin e mësimdhënësit tek ujërat e Drinit të Bardhë. Të nderuar po ju rikujtoj se komuna jonë është zgjedhur si komuna e parë për në nivele vendi për zbatimin e masave anti Covid - 19 nëpër shkolla, pra me këtë do të thotë se është treguar një vëmendje sa i përket masave që duhet të merën. Ky vlerësim është bërë nga dy organizata në nivel republike që kanë bërë kontrollë sistematike nëpër shkolla. Poashtu mundem të ju them se komuna jonë ka hyra në vitin 2021 shumë stabile, ku ka tejkaluar planin e të hyrave, pastaj ka shpenzuar buxhetin e vitit 2020 98%, poashtu ka miratuar buxhetin me kohë për vitin 2021, shpresojmë se me përmasimin e kushteve atmosferike të kemi aktivitete të cilat në një mënyrë ose tjetër prodhojnë efekte që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve të komunës sonë. Pastaj sa i përket mungesës së trotuareve kjo vije për shkak të ngushticave që i kemi nëpër prona, ka edhe situata të tjera që e vështirësojnë, pastaj kemi trafik të vështirësuar edhe për arsyet e punimeve që janë duke ndodhur në rrugën kryesore. Por besoj se me përmirësimin e kohës ne do të kemi aktivitete të cilat do të ndikojnë që këto që i përmendem të përmirësohen. Fjala tani është e juaja nëse keni ndonjë pyetje ne jemi këtu.

**Shaip Shala** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari komandant sa ka ndikuar pandemia në raportimin e rasteve në stacionin policor në krahasim me vitin 2019.

**Fazli Morina** – Mundem tē them lirishtē se pa marrē parasysh rrrethanat e pandemisē qē gjendemi tani e gati një vit, sipas statistikave nuk ka ndonjë ndryshim sillemi aty njëjtë, ka mundësi tē lëvizë një përqindje shumë e vogël ose më pak ose më shumë.

**Ymret Reshitit** – Pëershëndetje pér tē gjithë tē pranishmit, dua tē flas sa i përket sigurisë nē shkolla nē nivel Kosove nga aspekti i këshillit tē prindërve, pa e specifikuar komunën por nē përgjithësi si dukuri negative e cila na shqetëson neve si këshill i prindërve. Fatkeqësisht duhet tē na ndodhin rastet tragjike pér tē na përkujtuar neve se nuk jemi duke i kryer përgjegjësit tonë si institucionë dhe si shoqëri, pra ka tē bëjë pikërisht me prezencën e dhunës nëpër shkolla. edhe pas 20 vitesh përpjekjesh nga institucionet dhe prindërit, pér tē parandaluar prezencën e kësaj dukurie negative nē shkolla, si përfundim rasti i Prizrenit dhe rastet e tjera na tregojnë se ne nē këtë aspekt nuk kemi arritur mjaftueshëm tē i kryejmë përgjegjësitë tona, prandaj ne ende nuk kemi arritur tē krijojmë ambiente tē sigurta pér fëmijët tanë nē shkolla. siç e ceke rasti i Prizrenit qē ndodhi therja e një nxënësi me thikë, janë me ë vërtet lajme tepër shqetësuuese pér ne si shoqëri Kosovare, pér tē na përgatitur që tē reflektojmë pozitivisht kurse institucionet tona ta kenë si prioritet luftimin e dhunës nëpër shkolla.

**Kryetari** – I nderuari z. Ymret Reshitit ju kisha lutur që tē fokusoheni tek ngjarjet nē Komunën e Rahovecit, e jo tē flisni pér nivel vendi, sepse ne sot jemi nē takimin e KKSBB-së, pér komunën e Rahovecit. Nesër e kemi takimin me drejtorët e shkollave dhe me këshillin e prindërve dhe aty keni mundësi tē diskutoni, prandaj ju lusë që tani tē fokusoheni vetëm nē rendin e ditës, mos dilni jashtë këtij rendi tē ditës.

**Ymret Reshitit** – Pikërisht i nderuari kryetar unë desha tē dal pastaj edhe tek komuna jonë, ku fatmirësisht nuk kemi raste tē tilla dhe ajo çka kërkoj unë është bashkëpunimi i drejtorëve, bashkëpunimin e stafit mësimor së bashku me prindërit. Problemet qē ndodhin nē gjenezë brenda shkollës dhe që kanë si rezultat manifestimin e dhunës ti eliminojnë me kohë, para se rastet e tilla tē përfundojnë tragjikisht. Kjo është ajo që pata unë sa i përket kësaj teme dhe kërkoj falje nëse kam devijuar debatit.

**Kryetari** – Ju faleminderit z. Ymret Reshitit, poashtu edhe juve komendant, a ka edhe dikush tē shtoj diçka sa i përket kësaj pike tē rendit tē ditës, nëse jo atëherë pe marrim një konkluzion.

**Konkluzion** – Duhet tē përpinqemi bashkërisht pér çdo ditë që tē japim kontributin tonë pér një siguri më tē mirë, si atë tē përgjithshme, komunale, poashtu edhe specifike si nē këtë rast nëpër shkolla, nē trafik etj. kalojmë nē pikën e fundit:

4. Tē ndryshme - Tē nderuar a keni diçka tē shtonë sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju faleminderit tē gjithëve pér kontributin e dhënë, mirë u takofshim nē mbledhjet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar nē orën: 16:30

Procesmbajtësi

Agim Hoti



Kryetar i Komunës

Smail Latifi